

**Njoftim për Mbajtësit e Njësave të Fondit “Eurizon Manager Selection Fund” (“FCP”), një sipërmarrje e investimeve kolektive e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut.**

Me anën e këtij njoftimi njoftohen mbajtësit e njësave se shoqëria administruese e FCP-së (dmth. Eurizon Capital SGR S.p.A., duke vepruar përmes Degës së saj në Luksemburg) ka vendosur ndryshimet e mëposhtme në prospektin e FCP-së:

**1. Politika e qëndrueshmërisë e shoqërisë së menaxhimit**

Evoluimi i politikës së qëndrueshmërisë së shoqërisë së menaxhimit – i zbatueshëm për të gjitha fondet e FCP-së – me qëllim që:

- (i) të forcojë më tej masat mbrojtëse të parashikuara për makrostrategjinë e “Përjashtimit Negativ” të instrumenteve financiare, duke zbatuar përjashtime shtesë të bazuara në tregues të përzgjedhur të ndikimit negativ të parashikuar nga Rregullorja për Zbulimet në lidhje me Financat e Qëndrueshme (“**SFDR**”), duke bërë dallimin ndërmjet emetuesve korporativë dhe atyre qeveritarë;
- (ii) të zgjerohet metodologjia e përdorur për të identifikuar “investime të qëndrueshme” duke vlerësuar (i) përputhshmërinë e emetuesit me praktikatat e mira të qeverisjes, (ii) kontributin e tij pozitiv në një objektivi mjedisor ose social (jo vetëm bazuar në shkallën e përputhshmërisë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara), (iii) përputhshmërinë e tij me parimin “Mos shkakto dëm të konsiderueshëm”.

Ky zhvillim i Politikës së Qëndrueshmërisë së shoqërisë administruese do të pasqyrohet në prospektin e FCP-së, përfshirë informacionin parakontraktor sipas SFDR-së për fondet e FCP-së që i nënshtrohen nenit 8 të SFDR-së, dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në përbërjen aktuale të portofolëve të tyre. Ju lutem shkoni në [eurizoncapital.com](http://eurizoncapital.com) për përmbledhjen e politikës së qëndrueshmërisë së shoqërisë së menaxhimit.

**2. Përditësimi i politikave të investimit të fondeve**

Për të ruajtur përputhshmërinë me informacionin e bërë tashmë publik në kuadër të informacionit parakontraktor sipas SFDR-së të fondeve, pragu minimal i investimit në UCITS ose në UCI të tjera, i parashikuar në politikën e investimit të fondeve, rritet nga 51% në 70%. Ky përditësim nuk do të sjellë asnjë ndryshim në përbërjen aktuale të portofolëve të fondeve.

**Këto ndryshime do të pasqyrohen në prospektin e FCP-së të datës 1 korrik 2026 dhe në një version të përditësuar të Dokumentit të Informacionit Kryesor (KID) të fondeve. Këto dokumente do të jenë të disponueshme pa kosto në zyrën e Eurizon Capital SGR S.p.A. - Luxembourg Branch, në faqen e vet të internetit [www.eurizoncapital.com](http://www.eurizoncapital.com), në zyrën e regjistruar të Bankës Depozitare, si edhe në zyrat e regjistruara të agjentëve të shpërndarjes.**